

VENDIM
Nr. 196, datë 6.4.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 102, DATË 16.2.2022, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS E TË NIVELEVE TË PAGAVE
TË POZICIONEVE KOORDINATOR TË RRJETIT TË KOORDINATORËVE
KUNDËR KORRUPSIONIT NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS
SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 5, të vendimit nr. 102, datë 16.2.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Nëpunësit në pozicionet “koordinator” të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit në institucionet, pjesë e fushës së veprimt të këtij vendimi, përveç pagës mujore të përcaktuar në lidhjet nr. 1/1, nr. 1/2, nr. 2/1 dhe nr. 2/2, përfitojnë shtesën mujore për natyrë të veçantë pune, sipas përcaktimit në lidhjen nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i secilit institucion, pjesë e fushës së veprimt të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 3

SHTESA MUJORE PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE
PËR NËPUNËSIT NË POZICIONET “KOORDINATOR”, PJESE E RRJETIT TË
KOORDINATORËVE KUNDËR KORRUPSIONIT PËR INSTITUCIONET QË JANË
PJESE E FUSHËS SË VEPRIMIT TË KËTIJ VENDIMI

POZICIONI KOORDINATOR, NË:	SHTESA MUJORE PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE
- Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës - Drejtoritë vendore të kategorisë së parë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës - Drejtoritë vendore të kategorisë së dytë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës	18.000
- Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve - Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave	15.000
- Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit - Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura - Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit - Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara	10.000

- Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” - Spitalin Obsetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” - Spitalin Universitar të Traumës. - Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik “Koço Glozheni” - Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”. - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore - Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë - Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinci”, Elbasan - Spitalet rajonale - Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile - Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore - Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit - Drejtorinë Qendrore të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit - Drejtorinë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor - Drejtorinë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar - Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë - Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara - Autoritetin Rrugor Shqiptar në nivel qendror - Institutin e Shëndetit Publik - Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor në nivel qendror - Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial - Shërbimin Social Shtetëror në nivel qendror - Drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor - Drejtoritë rajonale të Arsimit Parauniversitar	5.000
--	-------